



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 117/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Hasan Shala dhe Nenad Laziq anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidatit Gëzim Kelmendi për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik PDK me seli në Kamenicë, për shkak të vendosjes së posterave në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.06.2014, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Kamenicë i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 850 ( tetëqind e pesëdhjetë ) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### **Arsyetim**

Me datën 03.06.2014, LVV-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 02.06.2014, rreth orës 12:00, në qendër të qytetit përkatësisht në afërsi të tregut të qytetit, më konkretisht në anësoret e rrugës publike ishin vendosur posterët e kandidatit Gëzim Kelmendi nga radhët e koalicionit PDK-PD.

Parashtruesi i ankesës ka theksuar se është shkelur neni 4.1 pika b) e Rregullës Zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi si dhe dëshmin e dëshmitarës Brikenë Ramabaja .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, PZAP-i, me datë 04.06.2014 e informoi subjektin politik PDK për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti dhe ka kërkuar që të përgjigjet në Kërkesë për përgjigje dhe Urdhër për të Ndërrmarrë Masa Përmirësuese, lidhur me ankesën Anr.117/14 që është bërë ndaj këtij subjekti politik prandaj ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.06.2014 deri në ora 09:00.

PZAP-i, e pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar, në të cilën theksohet se, posterat e PDK-së nuk janë vendosur nga personat e autorizuar, por nga personat e pa identifikuar dhe atë me qëllim të prishjes së imazhit të PDK-së si dhe kandidatit nga radhët e këtij subjekti. Më tutje ka shtuar se, konform nenit 20 janë ndërrmarë masa përmirësuese, ku janë larguar posterët në fjalë nga aktivistët e PDK-së. Parashtruesi i ankesës në përgjigje të ankesës i ka bashkangjitur 2 (dy) fotografi si dëshmi .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se si posterat e subjektit politik PDK janë vendosur në rrugë publike, gjë që e bënë përgjegjës subjektin politik PDK, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-së nr.03/L-73 të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. që ndalon mbulimin e posterave nga një subjekt tjetër politik.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti PDK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posterat e kandidatit për deputet ka qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e tyre. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se subjekti në fjalë, pas marrjes së kërkesës për përgjigje dhe urdhrit për përmirësimin e shkeljes së pretenduar në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, i'ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë posterat nga vendi ku ka ndodhur shkelja, po ashtu ka ofruar dëshmi që më datë 04.05.2014 janë informuar shefat e shtabeve zgjedhore për rregullat e kodit të mirësjelljes për subjektet politike.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik PDK është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të PDK-së për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1 dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 117/2014 më datën 05.06.2014.

Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*